



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË

KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

V E N D I M

Nr. 144 datë 22 / 12 / 2021

Për

Dhënien e ndihmës financiare z. Robert Nazir Bregu për dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e tij

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e datës të sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjith. Juridike dhe B.NJ, Sektori Emergjencave Civile, bazuar në ligjin 45/2019 "Për Emergjencat Civile" të nenit 29 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", V.K.M. nr. 329 datë 16.05.2012, "Për kriteret e procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose nga veprimtaria njerëzore", kreu III<sup>te</sup>, pika 2 gërma ë, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në ligjin nr. 68 / 2017, "Për financat e vetqeverisjes vendore", në ligjin nr 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", me V.K.B nr 147 datë 28.12.2020, "Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2021" të Bashkisë Korçë si dhe urdhërin nr.11 datë 11.01.2021 "Për detajimin e shpenzimeve korrente për vitin 2021" të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë sipas programeve.

V E N D O S I :

1. **Ti jepet ndihmë financiare z. Robert Nazir Bregu për dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e tij, një shumë prej 75.000 lek**
2. Shuma prej **75.000. lek** për këtë familje, do të përballohet nga fondi i miratuar për Emergjencat Civile në buxhetin e Bashkisë për vitin 2021 në programin e mbrojtjes nga zjarri dhe mbrojtjen civile me këtë strukturë buxhetore:

00                      03280      05 Art.6060000                      **75.000 lek** ( mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile )

3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria Juridike dhe Sektori i Emergjencave Civile në Bashki.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

